



KOLEGIJ - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

UDHËZUES PËR SHQYRTIMIN DHE RISHIKIMIN E SYLLABUSIT



Syllabusi duhet të hartohet sipas formatit zyrtar të aprovuar nga Kolegji Biznesi

Formati i syllabusit të Kolegji Biznesi përmban elementet si në vijim:

- Informatat kyçe të lëndës si: fakulteti në kuadër të së cilës bie lënda,
 - titulli i lëndës,
 - niveli i studimeve bachelor apo master,
 - nëse lënda është obligative apo zgjedhore,
 - viti i studimeve,
 - numri i orëve mësimore në javë,
 - numri i kredive ECTS,
 - Sa orë angazhim kanë për një kredi - ECTS
 - koha/vendi i mbajtjes së ligjeratave dhe ushtrimeve, të dhënat kontaktuese të bartësit të lëndës së bashku me asistentin e lëndës për pjesën e ushtrimeve;
- Ngarkesa e studentëve në aspektin e obligimeve akademike që i kanë në kuadër të lëndës, duhet të jetë në pajtim me rezultatet e mësimnxënies së studentëve për lëndën përkatëse, e cila duhet patjetër të jetë në pajtim me rezultatet e mësimnxënies së programit studimor;
- Metodatat e mësimdhënies që parashikohen të përdoren në kuadër të lëndës;
- Metodatat e vlerësimit;
- Literatura primare dhe sekondare;
- Plani mësimor ku përfshihet përmbajtja e lëndës për javë (përgjatë 15 javëve të një semestri);
- Politika e integritetit akademik në kuadër të lëndës si dhe kodi i sjelljes në kuadër të lëndës;

I. Përshkrimi i lëndës

Përshkrimi i lëndës duhet të jetë i qartë, konciz dhe informues. Përshkrimi i lëndës duhet të i dedikohet studentëve në mënyrë që ata t'a kuptojnë në mënyrë sa më të qartë ashtuqë lënda të jetë më e qasshme.

II. Qëllimet e lëndës

Qëllimet e lëndës duhet të jenë në pajtim me qëllimet e përgjithshme të programit të studimeve dhe nivelin përkatës të studimeve bachelor apo master, të specifikohen synimet e arritjes gjatë secilit modul.

III. Rezultatet e mësimnxënies

Rezultatet e mësimnxënies pasqyrojnë atë se çka studentët pritet të dijnë, kuptojnë apo të bëjnë pas përfundimit të suksesshëm të lëndës.

Rezultatet e mësimnxënies rekomandohet të ndjekin taksonominë e Bloom që përdor listën e foljeve që synojnë njohuritë, kuptimin, aplikimin, sintezën dhe vlerësimin e çështjeve që ndërlidhen me lëndën.

Rezultatet e mësimnxënies duhet të jetë të formuluar në formë të qartë dhe të jenë të shkurtëra e të sakta. Rezultatet e mësimnxënies duhet të përmbajnë informacion të përgjithshëm në kuadër të rezultateve të mësimnxënies.

Rezultatet e mësimnxënies duhet të jenë të matshme dhe të jenë të lidhura me format e vlerësimit në kuadër të lëndës;

IV. Relevanca e lëndës dhe pajtueshmëria me trendet

Syllabusi duhet të përfshijë edhe relevancën e lëndës dhe benefitet nga mësimnxënia në lëndën përkatëse.

Syllabusi gjithashtu duhet të përmbajë informacion se deri në çfarë mase mësimnxënia në lëndën përkatëse është në pajtim me trendet shoqërore, ekonomike dhe teknologjike.

V. Ngarkesa e studentit

Ngarkesa e studentit duhet të llogaris kohën e cila ju nevojitet studentëve që të implementojnë të gjitha aktivitetet e mësimnxënies të parapara me syllabus.

Ngarkesa e lëndës duhet të përmbajë:

- pjesëmarrjen në ligjërata dhe ushtrime të studentit,
- projektet individuale,
- projektet grupore,
- praktikën e detyrueshme në kuadër të lëndës nëse ka ajo lëndë
- detyrat e shtëpisë,
- studimin individual dhe kohën që i nevojitet studentit për përgatitjen e provimit.

Ngarkesa e studentit llogaritet duke llogaritur 1 ECTS=25 të punës së studentit. Në kuadër të llogaritjes së ECTS-së - ngarkesës është e domosdoshme të llogaritet edhe studimi individual i studentit.

VI. Metodologjia e mësimdhënies

Seksioni i metodologjisë së mësimdhënies kërkon nga mësimdhënësit që të paraqesin në mënyrë specifike dhe jo të përgjithshme të gjitha aktivitetet mësimore që janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të mësimnxënies nga ana e studentëve në kuadër të lëndës.

Metodat e mësimdhënies mund të jenë: rastet e studimit, prezentimet studentëve, esetë, punimet hulumtuese, ushtrimet, vizitat në terren, puna grupore, ligjëratat, ushtrimet, ditari mësimor, luajtja e roleve, debatet dhe shiqimi i filmave apo videove, e gjithë kjo në varshmëri të profilit të studimit. Të gjitha metodat mësimore duhet të përqendrohen në nxitjen e kureshtjes

për mësim tek studentët dhe të zhvillojnë të menduarit kritik tek studentët, përfshirë këtu edhe zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve praktike dhe jetësore.

VII. Metodologjia e vlerësimit

Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të përfshijë një sërë formash të vlerësimit si dhe të mos fokusohet vetëm në provimin final. Me vlerësim të vazhdueshëm inkurajohet aktiviteti i studentëve në lëndë gjatë tërë semestrit. Nota përfundimtare duhet të jetë shuma e të gjitha rezultateve të studentit të arritura në kuadër të aktiviteteve të ndryshme të dizajnuara me syllabus për arritjen e rezultateve të mësimnxënies si: pjesëmarrja, ushtrimet, detyrat e shtëpisë, esetë, punimet hulumtuese, projektet grupore, provimet messemestrale dhe provimi final.

VIII. Literatura

Syllabusi duhet të parashikojë materialet që i nevojiten studentit për lexim, ku përfshihen edhe publikimet aktuale të mësimdhënësit në mënyrë që të arrihet relevanca me trendet e fundit shkencore. Seksioni i literaturës duhet të ofrojë literaturën primare dhe sekondare dhe materiale shtesë për lexim që është literaturë shtesë për studentët e shkëlqyeshëm dhe të motivuar. Preferohet që publikimet në revista të mësimdhënësve të gjejnë vend në kuadër të literaturës primare apo sekondare në kuadër të syllabusit.

XI. Plani mësimor dhe përmbajtja e lëndës

Plani mësimor duhet të përmbajë detajet për çdo javë veç e veç dhe të përmbajë titujt e njësive mësimore, aktivitetet për përfshirjen e studentëve, orët e planifikuara mësimore për secilën njësi dhe për secilin aktivitet. Në orët mësimore duhet t'u jepet hapësirë edhe aktiviteteve mësimore siç janë ushtrimet, prezentimet grupore apo individuale, esetë, hulumtimet, luajtja e roleve etj.

XII. Politika e integritetit akademik dhe kodi i sjelljes

Ky seksion i syllabusit duhet të përmbajë politikën e integritetit akademik në kuadër të lëndës, për zero tolerancë ndaj plagjaiturës, kopjimit në provime, apo kopjime në prezentimet grupore dhe aktivitetet tjera mësimore. Tek Kodi i Sjelljes listohen sjelljet e lejuara gjatë diskutimit, orës mësimore, interaktivitetit me mësimdhënësin etj.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil (të mençur) dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fiken (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje. Aktivitetet tjera siç janë: kontrollimi i e-

mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Ndjekja e rregullave dhe udhëzimeve të stafit akademik në lidhje me standardet e performancës të theksuara nga profesorët gjatë prezantimit të programit mësimor;

Studentët duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin me respekt dhe nxisin mjedisin e ndershmërisë, sjelljes etike dhe respektit të ndërsjellë.

Plagjiatura është një vjedhje e pronës intelektuale. Plagjiatura është dështimi i profesorëve dhe studentëve për të cituar punën e të tjerëve dhe për të njohur idetë dhe fjalët e të tjerëve.

Shkeljet e plagjiaturës përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vijim:

- Kuotimi pa citime të duhura;
- Riformulimi pa citim të duhur;
- Njohja e pamjaftueshme e burimeve;
- Përdorimi i strukturës dhe organizimit të mendimeve, bazuar në autorë të tjerë pa cituar siç duhet punën e tyre.

Shkeljet e mashtrimit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm si këto në vijim:

- Ndarja e pyetjeve dhe përgjigjeve të provimeve me studentët e tjerë;
- Përdorimi i materialeve të paautorizuara si ndihmesë gjatë provimeve me libra të mbyllur;
- Përdorimi i një personi tjetër për të hyrë në provim si në provimet në klasë ashtu edhe në provimet në shtëpi;
- Paraqitja e punës së bërë nga të tjerët si e vetja, posaçërisht në detyrat e projekteve në lëndë;
- Bashkëpunimi me të tjerët në detyrat në shtëpi, të cilat janë punime individuale.



Klasifikimi i shkathtësive kognitive sipas Bloom		
Kategoria	Përkufizimi	Sjelljet e ndërlidhura
Njohuritë	Të kujtosh apo të mbash mend diçka pa pasur nevojë ta kuptosh medoemos, ta përdorësh apo ta ndryshosh	Defino, përshkruaj, identifikoj, emërto, listo, krahaso, mbaj mend, trego, rikujto, përzgjedh, poho
Të kuptuarit	Të kuptosh diçka që është komunikuar pa pasur nevojë që ta ndërlidhësh me diçka tjetër	Ndrysho, shpjego, jep shënime, llogarit, ndrysho, shndërro, grupo, shpjego, përgjithëso, jep shembuj, konkludo, interpreto, parafrazo, parashiko, rishiko, përmbledh, përkthe
Aplikimi	Të përdorësh një koncept të përgjithshëm për t'i zgjidhur problemet në një situatë të caktuar; duke përdorë materialet që i ke mësuar në situata të reja dhe konkrete	apliko, mirato, mbledh, ndërto, demonstro, zbulo, ilustru, intervistoj, shfrytëzo, manipuluj, ndërlidh, shfaq, zgjidh, përdor
Analiza	Të zbërthesh diçka në pjesë; mund të fokusohesh në identifikimin e pjesëve apo në analizën e marrëdhënieve ndërmjet pjesëve, apo njohjen e parimeve organizative	analizo, krahaso, ballafaqo, krijo diagram, bëje dallimin, copëto, dallo, identifikoj, ilustru, konkludo, skico, thekso, përzgjedh, ndajë, klasifikoj, ndaj në pjesë më të imëta
Sinteza	Të ndërlidhësh diçka të re duke i bërë bashkë pjesët e ideve të ndryshme për të krijuar një tërësi.	përziej, ndërto, ndrysho, kombino, hartoj, konceptoj, krijo, dizajno, formulo, gjeneroj, supozoj, planifikoj, parashih, prodhoj, rirëndit, rishiko, trego, shkruaj
Vlerësimi	Të gjykosësh vlerën e materialit apo metodave se si mund të aplikohen në një situatë të caktuar; të gjykosësh duke përdorë kritere të përcaktuara.	Prano, çmo, vlerëso, gjyko, shpërble, zgjidh, konkludo, kritikoj, mbrojt, vlerëso, grado, gjyko, cakto prioritetet, rekomando, arbitroj, refuzoj, përzgjidh, përkrah.
Dallimi mes Bachelor dhe Master		
Bachelor	- Kupton, interpreton, shpjegon, përmbledh - Aplikon, zbaton, performon, ekzekuton, përdor	
Master	- Analizon, krahason, organizon - Vlerëson, kritikon, gjykon, eksperimenton, - Krijon, dizajnon, prodhon, projektton	





KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

www.kolegjbiznesi.cominfo@kolegjbiznesi.com

+383 | 038 500 878 | 044 500 878 | 049 500 878 Prishtinë, Ulpianë, Bulevardi, "Dëshmorët e Kombit" nr.

5

PLANPROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS

PLANPROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
1.Niveli i studimeve	Master	2.Programi studimor	Menaxhment dhe Financa		3.Viti Akademik		2024/25
4.Kodi i lëndës		5.Emërtimi i lëndës	Politikat e Zhvillimit Rajonal				
6.Viti studimit	I	7.Semestri	I	8.Statusi i lëndës	Z	9.ECTS	6
10.Javët mësimore	15	11.Ligjërata	2	12.Ushtrime	0	13.Gjithsej orë	2
14. Mësimdhënësi	Prof.asoc.dr. Betim Spahiu			Tel/mob	044 507 107		
				e-mail	betim.spahiu@kolegjbiznesi.com		
15. Asistent				Tel/mob			
				e-mail			
16.Metodat e mësimdhënies		Ligjërata e drejtpërdrejtë, Mënyra konkretizimi, Puna me grupe, Pune praktike					
17.Parakushtet për regjistrimin e lëndës (Ndërvlerësia me lëndët tjera të kurrikulës)			Të ketë përvetësuar Menaxhimin e avancuar i financave publike				
18.Konsultime me studentë	Dy orë në javë sipas orarit të shpallur në fillim të semestrit. Mësimdhënësi është në dispozicion të studentëve gjithnjë për konsultime me studentët në të gjitha format e komunikimit: prezencë fizike, e-mail, përmes platformave për komunikim ZOOM, Skype dhe ngjashëm.						
19.Përshkrimi i lëndës	Lënda jep njohuri teorike dhe praktike të zhvillimit ekonomik nga aspekti rajonal (territorial). Me këtë rast studentët do të mësojnë për kuptimin dhe bazat e politikës së zhvillimit rajonal, aspekti rajonal në kuadër të shkencave tjera ekonomike dhe mbi metodat e studimit të aspektit rajonal. Nga kjo lëndë, studentët do të fitojnë njohuri profesionale për teorinë kryesore mbi zhvillimin rajonal, duke përfshirë teorinë e lokacionit dhe konceptet bashkëkohore teorike në zhvillimin rajonal. Madje, nga programi i kësaj lënde studentëve u ofrohet njohuri për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe aspektin rajonal të zhvillimit. Këtu, në veçanti studentët përfitojnë njohuri për investimet demografike dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik. Me programin e kësaj lënde, studentët do të marrin njohuri për politikën e zbatuar të zhvillimit rajonal në vendet e zhvilluara të botës, përkatësisht me masat konkrete të politikës së zhvillimit rajonal të këtyre vendeve, si: në SHBA, Angli, Gjermaninë Federale, Francë, Itali, në Bashkimin Evropian. Programi i kësaj lënde, studentëve u ofron njohuri për definimin dhe kriteret e matjes së nivelit të zhvillimit të vendeve jo mjaft të zhvilluara të botës. Në veçanti do të njoftohen me mendimin rreth shkaqeve të ngesjes së zhvillimit të vendeve jo mjaft të zhvilluara dhe strategjinë e zhvillimit të këtyre vendeve. Me programin e kësaj lënde, studentët marrin njohuri për definimin e rajoneve ekonomike, rajonizimin ekonomik dhe përcaktimin e nivelit të (mos) zhvillimit, si bazë e zhvillimit rajonal. Programi i kësaj lënde, studentëve u ofron njohuri mbi politikën e zbatuar, përkatësisht mbi masat konkrete në politikën e zhvillimit rajonal në ish Jugosllavi dhe në Kosovë. Me programin e kësaj lënde, studentët njoftohen me ecuritë konkrete ekonomike të Kosovës pas çlirimit (1999). Nga kjo lëndë studentët, njoftohen me hapësirën si komponentë e veçantë të zhvillimit rajonal (territorial).						

20.Objekti vat e mësim nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të: 1. Analizon dhe krahason konceptet themelore të zhvillimit rajonal, duke shqyrtuar shkaqet, pasojat dhe dinamikat e zhvillimit rajonal. 2. Vlerëson dhe analizon rreziqet që lidhen me zhvillimin rajonal dhe qasjet për menaxhimin e tyre. 3. Analizon dhe gjykon domosdoshmërinë e zhvillimit rajonal si komponent i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. 4. Analizon dhe vlerëson ndikimin e faktorëve socialë dhe ekonomikë në zhvillimin rajonal. 5. Krijon dhe organizon raporte profesionale mbi politikat dhe ndërhyrjet në fushën e zhvillimit rajonal, duke vlerësuar rezultatet dhe pasojat e tyre.
21.Rezultat et e mësim nxënies	Pas përfundimit me sukses të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: 1. Klasifikoj konceptet themelore të zhvillimit rajonal, duke përfshirë njohuritë mbi shkaqet dhe pasoja e dinamikave rajonale; 2. Identifikojë rreziqet e mundshme të zhvillimit rajonal dhe ka njohuri të mjaftueshme për menaxhimin e tyre 3. Analizoj domosdoshmërinë e zhvillimit rajonal, si komponent e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. 4. Analizoj ndikimin e aspekteve sociale dhe ekonomike në zhvillimin rajonal. 5. Komunikojë dhe raportojë efektivisht mbi politikat dhe ndërhyrjet e ndërmarra në fushën e zhvillimit rajonal, përfshirë rezultatet dhe pasojat e tyre

22. METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TEMAVE MËSIMORE

Formati i mësimdhënies përfshin orët e ligjëratave (zhvillimi i kureshtjes) të studentëve dhe stimulojnë pjesëmarrjen aktive të tyre (**zhvillim i mendimit kritik**), punë praktike përmes realizimit të projektit i cili do të **zgjidhë problem të caktuar** sipas idesë së paraqitur nga studenti, dokumentim i projektit, prezantim i projektit (**projekti i ndarë në detyra**), si dhe mësim individual në mënyrë që të krijojnë raporte më personale me mësimdhënësin. Studentët duhet ta kryejnë obligimet e tyre personale të përcaktuara për lëndën, gjatë gjithë kohës të tutoruar nga mësimdhënësi.

Lënda përfshin aktivitetet e mëposhtme arsimore:

Ligjërata, të drejtuara nga mësimdhënësi përgjegjës për lëndën përkatëse, në të cilat ligjërata prezantohen dhe diskutohen temat qendrore të programit të lëndës.

Punë praktike, të drejtuara nga asistenti përgjegjës për lëndën përkatëse, në të cilat diskutohen temat qendrore të programit të lëndës.

Punim seminari, aktivitet individual

Sesione praktike, në të cilat inkurajohet pjesëmarrja aktive e studentëve për të zhvilluar aftësitë e tyre kërkimore, të folurit, diskutimit dhe punës në grup.

Projekte dhe Raste të studimit:

Tutoriale: aktivitete individuale, qëllimi i të cilave është të mbikëqyrin përparimin dhe zhvillimin akademik, orientimin profesional dhe udhëzimin në të ardhmen në lidhje me aftësitë transversale.

Punë ekipore: aktivitete në grup që kryhen në grupe të vogla në klasë për përvetësimin e aftësive të përgjithshme dhe të të nxëniet të pavarur.

Punë individuale: aktivitete të pavarura të kryera nga studenti, si përfundimi i punë praktikeve, shkrimi i lëndëve dhe raporteve dhe prezantimet me gojë.

Ligjërues i jashtëm,

23. KUSHTET PËR REALIZIMIN E TEMËS MËSIMORE

Salla të ligjëratave dhe punë praktikeve të pajisura me kompjuter dhe projektor, tabela për ushtrimin e detyrave.

24. METODAT E SIGURIMIT TË CILËSISË QË MUNDËSOJNË PËRVETËSIMIN E KOMPETENCAVE

Gjatë realizimit të procesit për sigurimin e cilësisë në këtë lëndë do të shfrytëzohen metodat e ardhshme me qëllim që të mundësohet përfitimi i kompetencave të përcaktuara në kurrikulë:

- Monitorimi i frekuentimit të ligjëratave dhe përmbushja e detyrimeve të studentëve (Mësimdhënësi)
- Mbikëqyrja e mësimdhënies (Prodekani për çështje akademike dhe studentore)
- Analizë e performancës së studimeve për të gjitha lëndët e programit të studimit (Prodekani për Çështje akademike dhe studentore)
- Anketa e studentëve për cilësinë e mësimdhënësve dhe mësimdhënies për çdo lëndë të programit studimor (Zyra për Sigurimin e Cilësisë)
- Të gjitha rezultatet e mësim nxënies të lëndës shqyrtohen nga provimi i realizuar dhe përfunduar nga mësimdhënësi i lëndës.
- Kontrollimi periodik i përmbajtjes së provimit bëhet për të verifikuar përshtatshmërinë e metodës së vërtetimit të rezultateve të mësim nxënies (Prodekani për çështje akademike dhe studentore).

25. VLERËSIMI I REZULTATEVE TË MËSIM NXËNIES

Metodat e Vlerësimit		Në %	Pikë	Nota përfundimtare		
Vlerësimi formues (formativ)	Prezantimi grupor	0 - 5	91-100	10	Dhjetë	A
	Prezantim individual	0 - 10	81-90	9	Nëntë	B
	Aktivitet	0 - 5	71-80	8	Tetë	C
	Punim seminar	0 - 10	61-70	7	Shtatë	D
	Provimi parcial I (Colloquium)	0 - 20	51-60	6	Gjashtë	E
	Provimi parcial II (Colloquium)	0 - 20	0-50	5	Pesë	FX
Vlerësimi përmblendhës (sumativ)	Provimi përfundimtar	0 - 30				

26. OBLIGIMET E STUDENTIT

Ligjërata	Pune praktike
Prezenca në ligjërata, Aktiviteti në ligjërata, Punim seminarik grupor, Punim seminarik individual, Hartim i Projektit, Pjesëmarrje në teste, Provimi përfundimtar	Prezenca në pune praktike, Aktiviteti në pune praktike, Puna individuale dhe grupore në raste studimi, Pjesëmarrje në diskutime.

27. NGARKESA E STUDENTIT PËR LËNDËN

***Vërejtje:** 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim

p.sh. nëse lënda ka 5 ECTS studenti për këtë lëndë ka gjithsej angazhim gjatë semestrit 125 orë

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Punë praktike			
Kontakte me mësimdhënësin	1	4	4
Pune praktike në teren			
Provime parciale (Colloquium-e)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Studimi vetanak	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15	45
Koha e kaluar në vlerësime (teste, provimi final)	2	1	2

Projekt propozim		2	5	10
Ngarkesa totale e studentit:				150
J a v a	Ligjërata		Pune praktike	
	Tema		Orë	
1	Nevoja e zhvillimit ekonomik edhe nga aspekti rajonal. Nocioni dhe lënda e zhvillimit rajonal. Metodat në studimin e zhvillimit rajonal Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq 15-31		2	
2	Mendimi ekonomik mbi zhvillimin rajonal. Teoritë e lokacionit. Koncepti bashkëkohor teorik në zhvillimin rajonal Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq 52-70		2	
3	Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik dhe aspekti rajonal i zhvillimit. Dinamika dhe modelet e zhvillimit. Nocioni i termave “shtim” dhe “zhvillim” ekonomik Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 75-88		2	
4	Investimet demografike dhe ndikimi i tyre në dinamikën e zhvillimit ekonomik. Nocioni dhe metodat e vlerësimit të investimeve demografike. Ndërlidhshmëria mes investimeve demografike dhe dinamikës së zhvillimit ekonomik. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 91-95		2	
5	Masat dhe mjetet që ndërmarrin disa vende të zhvilluara të botës në politikën e zhvillimit rajonal. Politika e zhvillimit rajonal në SHBA. Politika e zhvillimit rajonal në Angli. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 107-148		2	
6	Politika e zhvillimit rajonal në Gjermaninë Federale. Politika e zhvillimit rajonal në Francë. Politika e zhvillimit rajonal në Itali. Politika e zhvillimit rajonal në ish Jugosllavi dhe në Kosovë. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 155-168		2	
7	Colloquium I		2	
8	Mendimi rreth shkaqeve të ngecjes së zhvillimit ekonomik të vendeve jo mjaft të zhvilluara të botës dhe strategjia e zhvillimit Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 177-189		2	
9	Definimi i rajoneve ekonomike, rajonizimi ekonomik dhe përcaktimi i nivelit të (mos) zhvillueshmërisë, si bazë e zhvillimit rajonal Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 213-228		2	
10	Zhvillimi ekonomik i Kosovës në përidhën e pas çlirimit. Hapësira si komponente e zhvillimit ekonomik dhe rajonal Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 233-253		2	
11	Shkaqet e ngecjes së zhvillimit ekonomik të vendeve jo mjaft të zhvilluara.		2	

	Strategjia e zhvillimit ekonomik të vendeve jo mjaft të zhvilluara. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 257-268	
1 2	Nocioni dhe llojet e rajoneve ekonomike. Rajonizimi ekonomik dhe përcaktimi i nivelit të (mos) zhvillueshmërisë. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 268-279	2
1 3	Modeli i financimit të viseve jo mjaft të zhvilluara në ish Jugosllavi. Fondi Federativ për kreditimin e republikave jo mjaft të zhvilluara dhe krahinat autonome. Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 280-293	2
1 4	Colloquium II.	2
1 5	Lënda dhe ndarja e ekonomisë hapësinore. Formimi i qyteteve Politika e zhvillimit rajonal – Prof. Dr Musa Limani, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018, fq. 301-317	2
28. LITERATURA BAZË		
1. Prof. Dr Musa Limani, Politika e zhvillimit rajonal, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018. 2. Prof. Dr Musa Limani, Ekonomia e Kosovës, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2018.		
29. LITERATURA PLOTËSUESE		
1. Prof. Dr Justina Shiroka-Pula, Zhvillimi ekonomik dhe investimet demografike në Kosovë, Prishtinë, 1997. 2. Grup Autorësh, redaktor Muhamet Mustafa, Ekonomia e Kosovës, Riinvest, Prishtinë 2018 3. Paul A. Samuelson & William D. Nordhaus, Ekonomiksi 19e, Educational Center, Prishtinë, 2022		
30. PREZENCA E STUDENTËVE		
Pjesëmarrja e rregullt, aktiviteti gjatë ligjëratave dhe dorëzimi i detyrave janë thelbësore për suksesin e studentëve. Për këtë arsye: • Prezencë e rregullt në të gjitha ligjëratat pritet nga të gjithë studentët. Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 20% të orëve (3 mungesa brenda semestrit), nëse ato janë të arsyetuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. • Prezencë e rregullt në të gjitha punë praktike pritet nga të gjithë studentët. Orët e punë praktikeve janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të arsyetuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me mësimdhënësin. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. • Mungesat që i atribuohen përfaqësimit të Kolegjit në ngjarje të miratuara zyrtarisht (konferenca, konkurse dhe udhëtime në terren) do të llogariten si mungesa me leje (të arsyetuara). • Studimet akademike kërkojnë përpjekje dhe përkushtim të konsiderueshëm dhe prandaj të gjithë duhet të jenë prezent dhe të përkushtuar në procesin edukativ dhe arsimor.		
31. PLAGJIATURA		
Plagjiaturë është të marrësh dhe të prezantosh si të vetat shkrimet ose idetë e të tjerëve, pa përmendur fare burimin. Studentët duhet të kuptojnë konceptin e plagjiaturës dhe ta kenë parasysh këtë gjatë dhënies së provimeve dhe përgatitjes së materialeve dhe detyrave të tyre me shkrim. Prandaj, nëse kanë paqartësi ose nuk e kuptojnë se si të "citohet një burim saktë", duhet të kërkojnë ndihmë. Studentëve do t'u kërkohej që të dorëzojnë punimet e diplomës, punimet e seminarit dhe esetë e tyre të lëndës në programin për anti-plagjiaturë që gjendet në ueb faqen e Kolegjit Biznesi për rishikim të ngjashmërisë tekstuale dhe zbulimin e plagjiaturës së mundshme. Duke vepruar kështu, studentët do të lejojnë që punimet dhe esetë e tyre të përfshihen si dokumente burimore në bazën e të dhënave të referencës, ku ato do të përdoren vetëm për		

qëllimin e zbulimit të plagjiaturës. Kushtet që zbatohen për përdorimin e shërbimit për “Anti-plagjiaturë” nga Kolegji Biznesi përshkruhen në ueb faqe.

32. INTEGRITETI AKADEMIK

Mësimdhënësi dhe studentët në punën dhe studimet akademike të tyre do të veprojnë në mënyrë **të ndershme, të drejtë, të respektueshme dhe të përgjegjshme**. Mashtrimi përkufizohet si hile, gënjeshtëri ose pandershmëri në një detyrë akademike ose përdorim ose përpjekje për të përdorur materiale, ose të ndihmohen të tjerët në përdorimin e materialeve të cilat janë të ndaluara ose të papërshtatshme në kontekstin e detyrës akademike në fjalë. Kushdo që kapet duke mashtruar do të marrë zero pikë në provim ose detyrë dhe mësimdhënësi mund të raportojë incidentin tek Komisioni Disiplinor i Kolegjit Biznesi, i cili do të vendos për veprimet e mëtejme. Studentët duhet ti referohen Kodit të Etikës të Kolegjit Biznesi për më shumë informacion mbi pandershmërinë akademike ose të tjera sjellje të pahijshme. Veprimet e mashtrimit përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon: plagjiaturë; kopjim ose përpjekje për të kopjuar nga të tjerët gjatë një provimi ose në një detyrë; komunikimi i informacionit të testit me një person tjetër gjatë një ekzaminimi; lejimi i të tjerëve të bëjnë një detyrë ose një pjesë të një detyre; përdorimi i punimeve të blera të përgatitura nga të tjerët për shpërblim, etj. Të gjitha rastet e dyshuara të pandershmërisë akademike do të hetohen sipas procedurave të përshkruara në Kodin e etikës në Kolegjin Biznesi.

33. VËREJTJE PËRFUNDIMTARE PËR STUDENTIN

Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar. Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet t'i prezantojnë dhe diskutojnë ato në orën e pune praktikeve.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat e institucionit;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, pune praktikeve dhe punimet e seminarit, të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e dokumentit për identifikim në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve të seminarit, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin e hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student.
- Prandaj, studentet duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet sipas normave të parapara me rregullore dhe Kodin e etikës.